

There are no translations available.

**Njohur me Vendim të Gjykatës të rrethit Tiranë n 7078 date 15/09/2016 - President z. Dritan Korumi**

Programi dhe qellimet: Sindikata e shëndetësisë Shqiptare synon të realizojë interes e anëtarësisë së saj në kushtet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste që punon për prosperitetin , për përmirësimin e nivelit të jetesës dhe rritjes së dinjitetit kombëtar të shqiptarëve . SPSHSH shpreh qartë në Statut dhe programet e saj mbrojtjen me mjete ligjore , demokratike dhe kushtetuese të interesave ekonomike sociale dhe juridike të anëtarësisë së saj . Ajo punon për realizimin e të drejtave në marrëdhëniet e punës , të shpërblimit , të mbrojtjes nga diskriminimi , të zbatimit të legjislacionit të punës në kuadrin e dialogut social nëpërmjet aksioneve sindikale të negocimeve ,si dhe formave të tjera demokratike .

E drejta e anëtarësimit: Çdo anëtar që punon në sektorin e shëndetësisë ka të drejtë të anëtarësohet në SPPSSH.

Pranimi i çdo invidi në organizatën sindikale bëhet nëpërmjet deklarimit të tij në Këshillin Sindikal të Ndërmarrjes apo Institucionit për t'u anëtarësuar duke pranuar statutin dhe programin e sindikatës.

Sektorët që mbulon shërbimi shëndetësor : (SPPSSH) përfaqëson të gjithë punëmarrësit që janë të punësuar në sektorin e shërbimit parësor dhe spitalor.

Shtrirja e strukturës sindiakle është në të gjithë prefekturat dhe rrethet .

Selia e saj ndodhet ne zyrat e BSPSH dhe aderon prane BSPSH  
**Presidenti** i kësaj sindikate është **z. Dritan Korumi**